



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
Nr.02.1466/1
29.03.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 12, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 4, dhe në lidhje me nenin 8 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 42/20 dhe 77/21) dhe neni 11, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 11 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1 datë 29.7.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me Konkluzionin nr. 02-1364/2 datë 29.3.2023, në seancën e 12-të mbajtur më 28.3.2023 miratoi:

VENDIM

1. Miratohet Raporti vjetor për punë i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022 (me Raport për realizimin e planit vjetor për mbikëqyrje programore për vitin 2022 dhe Raport financiar për realizimin e planit financiar për vitin 2022 dhe llogari vjetore me të ardhurat e realizuara, shpenzime, kërkesa dhe detyrime për vitin 2022)
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, më së voni deri më 31 mars të këtij viti, është e detyruar të raportojë para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me dorëzimin e raportit për punën e saj në vitin paraprak.

Rrjedhimisht nga sa më lartë, është përgatitur Raport vjetor për punë i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, i cili në pajtim me nenin 8 paragrafi (4) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, përmban: raport për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në programin vjetor për punë të Agjencisë për vitin 2022, raport për realizimin e planit vjetor për mbikëqyrje programore për vitin 2022, raport financiar për realizimin e planit financiar për vitin 2022 dhe llogari vjetore me të dhëna për të ardhurat e realizuara, shpenzime, kërkesa dhe detyrime për vitin paraprak, të grupuara sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të Agjencisë, si dhe raport auditimi nga revizor i pavarur ndërkombëtar i autorizuar dhe qëndrim të Agjencisë në lidhje me rezultatet nga revizioni (auditimi) i kryer.

Duke marrë parasysh siç u përmend më lartë, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 12, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 4, dhe në lidhje me nenin 8 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18,

27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 42/20 dhe 77/21) dhe neni 11, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 11 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1 datë 29.7.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me Konkluzionin nr. 02-1364/2 datë 29.3.2023, në seancën e 12-të mbajtur më 28.3.2023, miratoi Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Kopje e vendimit t'i dorëzohet:

- Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit;
- Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtje të së drejtës së autori;
- Sektorit për mbështetje informative dhe punë të përgjithëshme – arkivi.